

01-1892



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-190986/21 dt. 10.09.2021, të pronarëve Ali Qyqalla, Mehdi Qyqalla, Sami Qyqalla dhe “Pozhegu Brothers” Sh.p.k. me investitor “Pozhegu Brothers” Sh.p.k. nga Prishtina me certifikatë të regjistrimit ARBK 811251032, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “A-6”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në rr. “Ndue Perllëshi”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 23.03.2022, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve Ali Qyqalla, Mehdi Qyqalla, Sami Qyqalla dhe “Pozhegu Brothers” Sh.p.k. me investitor “Pozhegu Brothers” Sh.p.k. nga Prishtina me certifikatë të regjistrimit ARBK 811251032, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-190986/21 dt. 10.09.2021, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa “2”, “3”, “4” dhe “5”, me etazhitet B+P+6 (duplex), e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-126275 dt. 16.11.2017, Vendimit për Plotësim Ndryshim të Vendimit të Lejes ndërtimore 05 Nr. 351/02-126275 dt. 26.09.2018, Vendimit për Plotësim Ndryshim të Projektit Kryesor 05 Nr. 351/05-161224/19 dt. 15.12.2020, në kuadër të bllokut urban “A-6”, të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1592-1, ZK Matiçan.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugët “Ndue Perllëshi” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 91, 95, 97, 99, 105, 107, 109 dhe 111 në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njërive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarëve Ali Qyqalla, Mehdi Qyqalla, Sami Qyqalla dhe “Pozhegu Brothers” Sh.p.k. me investitor “Pozhegu Brothers” Sh.p.k. nga Prishtina me certifikatë të regjistrimit ARBK 811251032, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-190986/21 dt. 10.09.2021, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa “2”, “3”, “4” dhe “5”, me

etazhitet B+P+6 (duplex), e ndërtuar në kuadër të bllokut urban "A-6", të tërësisë urbane "A", të Planit Rregullues "Mati 1", në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1592-1, ZK Matiçan, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-126275/17 dt. 16.11.2017, Vendimit për Plotësim Ndryshim të Projektit Kryesor 05 Nr. 351/02-126275/19 dt. 26.09.2018, Vendimit për Plotësim Ndryshim të Projektit Kryesor 05 Nr. 351/05-161224/19 dt. 15.12.2020, të lëshuara nga Drejtoria e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Njoftim", me referencë 09 Nr. 391/02-68049/21 dt. 07.09.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimit mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuarit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografji gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e udhëheqësit të vendpunishtes Faton Qarri; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Krenare Kadriu; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Rexhep Saliu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Violeta Hoxha; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Asmir Hamdi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Korab Lushta; Raportin e përfundimit të punëve të instalimit të pajisjeve për mbrojtje nga zjarri Arban Shala; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i Burim Halilaj me nr. të licencës 195;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimeve makinerike, instalimeve për mbrojtje nga zjarri, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuarit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-190986/21 DT. 23.03.2022**

Zyrtari,
Berim Osmanaj

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi



